




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-0/DPK	Br. Prot. 01-1256/13
Nr. I fac.	Prot. No.
Broj stranica	Date
Nr. pages 02	Datum 24.04.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **19.04.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. ***Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-908/13 për ztr. Avni Zogu – Drejtor i Administratës në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.***

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-908-13, për Zyrtarin e lartë, z. Avni Zogu – Drejtor i Administratës në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-908/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Zogu së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me dyshimin e bazuar për situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari Zogu në këtë takim ka njoftuar se sipas dijenisë së tij, biznesin e identifikuar nga AKK, ai e ka shuar në mënyrë vullnetare, dhe për këtë ka dëshminë nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të cilën do të na e dërgon ditëve në vijim.

Ndërkohë, pas këtij takimi, Zyrtari i lartë, z. Zogu, në Agjenci ka dërguar një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-1143/13) të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë në të cilën shihet se z.Zogu, në mënyrë vullnetare e ka shuar biznesin privat “Alb Vizion” me çka njëkohësisht ka parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

